


Është sunet që imami dhe ai që falet vetëm të ketë përpara vetes pengesë «sutre», sutreja e imamit është sutre për ata që janë pas tij.




Shikimin e tij e drejton në vendin ku bie në sexhde dhe nuk lëviz.




1

Hapësirën e këmbëve e bën sa gjerësia e shpatullave, pa shtuar e as pakësuar, duke i drejtuar pjesën e jashtme të tyre.






2

Pasi i plotëson kushtet e namazit, thotë "Allahu Ekber" duke ngritur duart, me gishta të mbledhur, në drejtim me veshët ose me shpatullat, dhe shputat e shuplakave i drejton nga drejtimi e kibles.



3

Pastaj vendos pjesën e brendshme të shuplakës së tij të djathtë në pjesën e sipërme të pëllëmbës së majtë, në kyçin e dorës dhe parakrah, "në gjoks" ose me kapje.



4

Pastaj është e pëlqyeshme që ai të lexojë lutjen e hapjes vetëm në rekatin e parë, më e mira është që të bëjë zgjedhje mes lutjeve të përmendura në sunet.

Të thotë: Subhaneke All-Ilahumme we bi hamdike we tebarekesmuke we te'ala xhedduke we la ilahe gajruke.

Pastaj kërkon strehim nga Allahu duke përmendur ato lutje që ka ardhur në argumente e të thotë: "Eudhu bilahi mine shejtani rrxhim Bismilahi Err-rrahmane rrahim".


Pastaj lexon El-Fatihanë të renditur me vargjet, fjalët, shkronjat dhe zanoret e saj.

1- Bismil'lahi Rrahmani Rrahim. 2-El hamdu lil'lâhi rabbil alemin. 3-Er Rahmanir Rahim. 4-Maliki jeumid din. 5-Ijjake na'budu ue ijake nestein. 6-Ihdines siratal mustekim. 7-Siratal ledhine en'amte alejhim, gajril magdubi alejhim ue led dal'in.

Pastaj lexon çfarë të mundet nga Kurani, pa thënë "istiadhen" por thotë: Bismil'lahi Rrahmani Rrahim në fillim të sureve.

5

Pastaj i ngre duart ashtu siç i ngriti në tekbinin fillestarë duke thënë: "Allahu Ekber" dhe bie në ruku, pastaj i kap gjunjët dhe nuk i përkul bërrylat dhe shpinën e mban të sheshtë dhe të drejtë me kokën dhe thotë një herë si obligim: "Subhane Rabiël Adhijm" është e pëlqyeshme të shtojë nga ato lutje që jan pwrmentur në argumente.




6

Pastaj, me ngritjen dhe para se të drejtohet, thotë: "Semia Allau limen hamide", me të dyja duart të ngritura në drejtim me veshët ose me shpatullat.

Kur të drejtojë trupin të thotë: " Rabena ue lekel hamd" Dhe është e pëlqyeshme që ai të shtojë ato lutje që kanë ardhur në argumente.


Pastaj duhet të thotë tekbinin pa i ngritur duart dhe të bëjë sexhde në shtatë pjesët: ballin, hundën, brendësinë e duarve, gjunjët dhe shputat e gishtave të këmbës.

Duhet të jenë të ndara ndërmjet sqetullave, midis barkut dhe kofshës dhe midis kofshës dhe këmbës dhe të ngrejë krahët nga toka.





7

Të thotë: " Subhane Rabiël Eala" një herë dhe kjo është obligim, është e pëlqyeshme të shtojë aq sa ka ardhur në argumente, mund të lutet për çfarë të dëshirojë, më e mira të lutet me ato lutje të përmendur në argumente.



8

Pastaj të thotë tekbinin dhe ulet në këmbën e majtë të shtrirë, e ngre të djathtë dhe i vendos shputat e gishtave të djathtë në tokë dhe gishtat drejt kibles dhe i vendos shputat e shuplakave në skajet e kofshëve dhe thotë "Rabi igfir li." Kjo ulje është në të gjitha uljet e namazëve, përveç namazëve që janë tri dhe katër rekatëshe në teshehudin e fundit, ulet duke vendosë këmbën e majtë nën kërcellin e këmbës djathtë.



9

Pastaj thotë tekbinin dhe bën sexhde si sexhdeja e parë, pastaj thotë tekbinin dhe ngrihet për rekatin e dytë dhe vepron në të siç bëri në të parin, vetëm se nuk ka tekbin fillestarë dhe as lutje hyrëse.

Pasi e përfundon sexhden e dytë, ulet për teshehud.




Pastaj e ngren gishtin tregues, me gishtin e mesit dhe gishtin e madh bën rrethore, gishtin tregues e lëviz duke u lutur me të.

E lexon teshehudin, pastaj lexohen salvatet ibrahimije: " Et-tehijjatu lil-lahi wes-salawatu wet-tajjibatu

Es-selamu 'alejke ejjuhen-nebijju We rahmetull-Ilahi we berekatuhu Es-selamu 'alejna we 'ala 'ibadil-lahis-salihin Esh hedu en la ilahe il-lall-Ilah We esh-hedu enne muhammeden 'abduhu we resuluhu. All-Ilahumme sal-li 'ala Muhammedin We 'ala ali Muhammed Kema sal-lejte 'ala Ibrahim we 'ala ali Ibrahim Inneke hamidun mexhid All-Ilahumme barik 'ala Muhammedin We 'ala ali Muhammed Kema barekte 'ala Ibrahim we 'ala ali Ibrahim Inneke hamidun mexhid".

Pastaj lutet dhe kërkon strehim nga katër gjëra: "- Allahumme inni eudhu bike min adhabi xhehenem ue eudhu bike min adhabil kabir, ue eudhu bike e min fitneti ed dexhal, ve eudhu bike min fitnetil mehja vel memati" pastaj të lutet për çfarë të dëshirojë, më e mira të lutet me ato lutje të përmendura në transmetime, duke thënë: Allahumme a'inni 'ala dhikrike ue shukrike ue husni 'ibadetike.

Pastaj jep dy selame djathtas dhe majtas dhe thotë: "Es-selamu 'alejkum we rahmetull-Ilah" dhe kthen vetëm kokën pa shpatullat e tij dhe pa e lëvizur kokën lart e poshtë dhe duke mos treguar me duart e tij me lëvizje.



10

